

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,15.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.07.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik " *Sigal Uniq Group Austria Sh. a* ", për aktivitetin: " **Sigurimi ndaj aksidenteve për nxënësit e shkollave profesionale dhe kandidatët nga qendra e karrjerës gjatë punës praktike** Nr. të Prok: 616 21 083 221nxjerr:

V E N D I M

1.Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "" *Sigal Uniq Group Austria Sh. a* ", për aktivitetin: " **Sigurimi ndaj aksidenteve për nxënësit e shkollave profesionale dhe kandidatët nga qendra e karrjerës gjatë punës praktike** Nr. të Prok: 616 21 083 221 , kundër Vendimit të AK-së , të datës 08.07.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të Vendimit të AK-së të datës 08.07.2021.

3.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik " ***Sigal Uniq Group Austria Sh. a*** ", me datë 10.07.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Sigurimi ndaj aksidenteve për nxënësit e shkollave profesionale dhe kandidatët nga qendra e karrjerës gjatë punës praktike Nr. të Prok: 616 21 083 221**

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.07.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Edhe pse pretendimet tuaja nuk janë plotësisht të qarta dhe nuk kanë asnjë dëshmi përcjellese shihet se pretendimi juaj kryesor është se tenderuesi i propozuar për kontratë është nën administrim të BQK-se dhe si i tillë është i pa përgjegjshëm. Ju e dini se BQK-ja është organi kompetent për licencim dhe kontroll të kompanive të sigurimeve dhe i njëjti në asnjë rast dhe për asnjë nga kompanitë asnjehere nuk ka bërë ndonjë njoftim zyrtar për gjendjen e asnjë kompanie të sigurimeve, pasi që sigurisht është kompetence e saj që këto ta trajtoj vetë. Edhe sikur të ishte ndonjë situatë e tillë në Autoritet Kontraktues nuk mund të veprojmë në kategorizimin e kompanive si të pa përgjegjshme nëse nuk kemi njoftim zyrtar nga BQK-ja. Që pretendimi të mos trajtohet si tendencioz ju sqaroj se edhe ju e edhe BQK-ja është dëshmitar për situatën e tillë para hapjes së tenderit, sepse në këto faze çka që mund të ofrohet nuk mund të merret si bazë për të përcaktuar fituesin e tenderit, por vetëm si tendencë e pa bazuar.


Për Autoritetin Kontraktues nuk ka asnjë bazë ligjore që të trajtojmë pretendimin tuaj si të pa bazuar dhe për këtë kërkesë juaj refuzohet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës, departamentit të prokurimit dhe njësisë së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankesuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit